



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“TELEKOMUNIKACION”

Niveli IV në KSHK¹, referuar nivelit IV të KEK²

K-E7-IV-24

Tiranë, 2024

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Përmbajtja

Emërtimi i kualifikimit	4
Kodi.....	4
Kohëzgjatja	4
Niveli.....	4
Qëllimi:	4
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	4
Mundësitë e kualifikimit të mëtijshëm dhe të punësimit:	4
Ofruesi.....	4
Data e validimit.....	4
Data e miratimit	4
Variantet e mëparshme	4
STRUKTURA E KUALIFIKIMIT	5
Kompetenca të përgjithshme.....	5
NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:.....	5
E7-05-IV-0164-24 Planifikimi dhe organizimi i punës në sektorin e telekomunikacionit.....	5
Rezultatet e të nxënit në njohuri	5
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	6
Kriteret e vlerësimit	6
E7-05-IV-0165-24 Punime për instalime të infrastrukturës mbështetëse të telekomunikacionit.....	6
Rezultatet e të nxënit në njohuri	6
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	7
Kriteret e vlerësimit	7
E7-05-IV-0166-24 Instalime të pajisjeve të telekomunikacionit.....	7
Rezultatet e të nxënit në njohuri	7
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	8
Kriteret e vlerësimit	8
E7-05-IV-0167-24 Diagnostikimi i problemeve në komponentët teknike të telekomunikacionit.....	9
Rezultatet e të nxënit në njohuri	9
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	9
Kriteret e vlerësimit	9
E7-05-IV-0168-24 Mirëmbajtje dhe riparime të infrastrukturës dhe pajisjeve të telekomunikacionit.....	9
	2

Rezultatet e të nxënit në njohuri	9
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	10
Kriteret e vlerësimit:	10
E7-05-IV-0169-24 Konfigurime bazë të pajisjeve të telekomunikacionit	10
Rezultatet e të nxënit në njohuri	10
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale:	11
Kriteret e vlerësimit:	11
E7-05-IV-0170-24 Teknologjia e informacionit në telekomunikacion	11
Rezultatet e të nxënit në njohuri	11
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	12
Kriteret e vlerësimit	12
E7-32-IV-0005-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere.....	13
Rezultatet e të nxënit në njohuri	13
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	13
Kriteret e vlerësimit	13
E7-31-IV-0006-24 Komunikimi dhe etika profesionale.....	14
Rezultatet e të nxënit në njohuri	14
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	14
Kriteret e vlerësimit	14
E7-05-IV-0171-24 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit	14
Rezultatet e të nxënit në njohuri	15
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	15
Kriteret e vlerësimit	15
Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:	16
Modalitetet e vlerësimit	16
Informacion shtesë	17
SHËNIM	17

Emërtimi i kualifikimit	“Telekomunikacion”			Kodi K-E7-IV-24
Kohëzgjatja	3000 orë nacionale	Niveli	IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK	
Qëllimi:	Qëllimi i kualifikimit profesional profili “Telekomunikacion” niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, është të përgatitë teknik të mesëm për kryerjen e instalimit, mirëmbajtjes dhe operimit të sistemeve të telekomunikacionit dhe të zhvillojë personalitetin e individit për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në institucionet e arsimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional “Telekomunikacion” të nivelit IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që: - kanë mbaruar dy vitet e para të shkollës së mesme në “Elektroteknikë”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK; - janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. - kanë <u>aftësi të kufizuara</u>, për të cilët institucioni arsimor krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Telekomunikacion” niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Supplementin përkatës të teknikut të mesëm, në këtë fushë. Ky kualifikim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës për punësim në ndërmarrje të shërbimeve të telekomunikacionit, duke përfshirë operatorët e rrjeteve të telefonisë, kompanitë e instalimeve dhe mirëmbajtjes së rrjeteve dhe sistemeve të telekomunikacionit, të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), si dhe ndërmarrjet që ofrojnë shërbime të internetit, IP TV. Përveç kësaj, individë mund të punësohet në veprimtari të tjera që lidhen me shërbimet e mbështetjes teknike të rrjetit, instalimet e pajisjeve të komunikimit, mirëmbajtjen e infrastrukturës së telekomunikacionit dhe menaxhimin e rrjeteve kompjuterike. Individë mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën telekomunikacionit. Me përfundimin e kualifikimit profesional “Telekomunikacion” niveli IV-të në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, individë ka mundësi për të fituar të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.			
Ofruesi	Ky kualifikim duhet të ofrohet nga ofrues të akredituar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.			
Data e validimit	Korrik 2024			
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	K-II-01-14;E7-IV-20			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Në përfundim të kualifikimit profesional “Telekomunikacion” niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, individit duhet të zotërojë njohuritë, shprehjet profesionale dhe kompetencat e përgjithshme të ndara sipas njësive të të nxënit të mëposhtme:

Kompetenca të përgjithshme

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të përgjithshme janë të vlefshme për të gjitha njësitë e të nxënit.

1. Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
2. Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
3. Të nxisë potencialin e tij/saj të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
4. Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
5. Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
6. Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj;
7. Të organizojë drejt procesin e të nxënit të tij/saj dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
8. Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuara;
9. Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
10. Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
11. Të marrë nisma për të bashkëpunuar me individë apo grupe;
12. Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari shkollore dhe komunitet;
13. Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për qenë pjesëmarrës pro aktiv në grup;
14. Të pranojë dhe të promovojë risitë dhe ndryshimet.
15. Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij, për t'u përshtatur me evolucionin teknologjik.

NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:

Standardet e kualifikimit hartohen në bazë të rezultateve të të nxënit (kompetenca të përgjithshme, njohuri dhe shprehje profesionale).

E7-05-IV-0164-24 Planifikimi dhe organizimi i punës në sektorin e telekomunikacionit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë veçoritë e sektorit të telekomunikacionit, tendencat e zhvillimit të sektorit dhe legjislacionin përkatës;
2. Të përshkruajë bazat e telekomunikacionit, sistemet e ndryshme të transmetimit;

3. Të listojë standardet e llojeve të komunikimit elektronik dhe praktikat e instalimit;
4. Të përshkruajë standardet në fushën e telekomunikacionit;
5. Të përshkruajë rëndësinë e interpretimit të projektit teknik dhe legjendën;
6. Të shpjegojë llojet e materialeve, karakteristikat dhe përdorimet e tyre;
7. Të shpjegojë llojet e mjeteve të punës dhe pajisjeve, funksionin dhe përdorimin e tyre;
8. Të përshkruajë sistemet e transmetimit në radio-frekuencë dhe përdorimin e tyre;
9. Të përshkruajë sistemet elektronike të komunikimit;
10. Të identifikojë sistemet e njoftimit të alarmeve dhe sinjalistikën e tyre;
11. Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit dhe organizimit të punës në mënyrë ergonomike;
12. Të analizojë planifikimin e burimeve të nevojshme dhe vlerësimin ekonomik të tyre;
13. Të listojë teknikat e vlerësimit të terrenit sipas planimetrisë;
14. Të përshkruajë procedurat e zbatimit të proceseve dhe radhës së punës;
15. Të analizojë burimet e rreziqeve, pasojat dhe rëndësinë e parandalimit të tyre;
16. Të përshkruajë rëndësinë dhe mënyrat e bashkëpunimit me eprorin dhe specialistë të tjerë;
17. Të përshkruajë rëndësinë e dokumentimit të punës dhe formatet përkatëse;
18. Të përshkruajë mënyrat dhe rëndësinë e raportimit tek eprori.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të planifikojë burimet njerëzore, materialet dhe mjetet e punës së nevojshme sipas projektit;
2. Të përcaktojë hapat e punës për zbatimin e projektit, në përputhje me udhëzimet teknike dhe standardet;
3. Të dokumentojë dhe raportojë realizimin e detyrave sipas procedurave;
4. Të mbikëqyrë ecurinë e zbatimit të punës duke analizuar rreziqet e mundshme gjatë zbatimit të projektit.

Kriteret e vlerësimit

- Interpreton drejt udhëzimet teknike për zbatimin e projektit;
- Analizon kushtet teknike të terrenit në varësi të planimetrisë;
- Planifikon materialet e nevojshme sipas projektit;
- Planifikon pajisjet dhe mjetet e punës të nevojshme sipas projektit;
- Planifikon burimet njerëzore të nevojshme sipas projektit dhe aftësive të kërkuara;
- Ndan detyrat sipas strukturës organizative dhe kualifikimeve përkatëse;
- Përcakton procedurat e zbatimit të proceseve dhe radhës së punës bazuar në projekt;
- Mbikëqyr ecurinë e zbatimit të punës sipas planit në kohë dhe në cilësi;
- Analizon rreziqet e mundshme në punë sipas rregullores së brendshme;
- Dokumenton në mënyrë periodike punën e kryer, sipas formateve përkatëse;
- Raporton në mënyrë periodike për realizimin e detyrave, sipas formateve përkatëse.

E7-05-IV-0165-24 Punime për instalime të infrastrukturës mbështetëse të telekomunikacionit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë llojet e kablllove dhe përdorimet e tyre;
2. Të shpjegojë llojet e sistemeve radio-valore;
3. Të shpjegojë procedurat dhe rregullat e instalimit të rrugëve të kalimit të kablllove;
4. Të shpjegojë procedurat e instalimit të pajisjeve;
5. Të shpjegojë procedurat e instalimit të kablllove të rrjetave: ethernet, telefoni, koaksial,

- sinjalizimi etj.;
6. Të përshkruajë procedurat e instalimit të rrjetit të fibrave optike;
 7. Të analizojë vlerat e parametrave të matur referuar kërkesave të projektit;
 8. Të shpjegojë pajisjet e testimit dhe përdorimet e tyre sipas teknologjisë së përdorur;
 9. Të argumentojë përdorimin e aparateve digjitale për matje dhe testim referuar kërkesave të projektit;
 10. Të shpjegojë teknikat e etiketimit dhe zbatimit përkatës.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të përzgjedhë materialet, pajisjet dhe mjetet e punës për kryerjen e instalimeve të infrastrukturës mbështetëse të telekomunikacionit;
2. Të zbatojë procedurat e instalimit të infrastrukturës mbështetëse të telekomunikacionit;
3. Të kryejë matje dhe testime pas instalimit të infrastrukturës mbështetëse të telekomunikacionit;
4. Të zbatojë teknikat e etiketimit pas instalimit të infrastrukturës mbështetëse të telekomunikacionit.

Kriteret e vlerësimit

- Përzgjedh materialet për kryerjen e instalimeve të infrastrukturës mbështetëse të telekomunikacionit, sipas kërkesave teknike të projektit;
- Përzgjedh pajisjet dhe mjetet e punës për kryerjen e testimeve dhe instalimeve të infrastrukturës mbështetëse të telekomunikacionit, sipas kërkesave teknike të projektit;
- Zbaton procedurat dhe rregullat e instalimit të rrugëve të kalimit të kabllave sipas kërkesave teknike të projektit;
- Zbaton procedurat e instalimit të pajisjeve, sipas kërkesave teknike të projektit dhe manualeve të pajisjeve;
- Zbaton procedurat e instalimit të kabllave të rrjetave: ethernet, telefoni, koaksial, sinjalizimi etj. sipas kërkesave teknike të projektit dhe manualeve përkatëse;
- Zbaton procedurat e instalimit të rrjetit të fibrave optike, sipas kërkesave teknike të projektit dhe manualeve përkatëse;
- Teston aparatet digjitale që përdoren për matje dhe testime, sipas procedurës dhe manualeve përkatëse;
- Mat parametrat e komponentëve të rrjetit sipas procedurës përkatëse;
- Teston pajisjet e instaluar të infrastrukturës mbështetëse të telekomunikacionit, sipas procedurës dhe manualeve përkatëse;
- Teston ndërlidhjen e komponentëve të infrastrukturës mbështetëse të telekomunikacionit, sipas procedurës dhe manualeve përkatëse;
- Krahason vlerat e parametrave të matura referuar kërkesave të projektit;
- Realizon përmirësimet e nevojshme në përputhje me kërkesat e projektit;
- Etiketon komponentët e infrastrukturës mbështetëse të telekomunikacionit, sipas procedurës dhe manualeve përkatëse.

E7-05-IV-0166-24 Instalime të pajisjeve të telekomunikacionit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë kushtet teknike të nevojshme të hapësirave për montimin e pajisjeve të telekomunikacionit;
2. Të shpjegojë llojet e burimeve të ushqimit dhe përdorimet e tyre;
3. Të analizojë manualët e pajisjeve para instalimit të tyre;
4. Të argumentojë përdorimin e aparateve dhe matjeve për kontrole të nevojshme;
5. Të shpjegojë procedurat e montimit të pajisjeve dhe aksesoreve përkatës;
6. Të shpjegojë procedurat e instalimit të pajisjeve në rrjet dhe testimet e nevojshme;
7. Të shpjegojë rëndësinë e regjistrimit të të dhënave të instalimit dhe raportimit;
8. Të shpjegojë procedurën e shkarkimit dhe ruajtjes së të dhënave të matura nga aparatet digjitale;
9. Të shpjegojë metodat e përpunimit paraprak të të dhënave të marra nga instrumentet digjitale;
10. Të shpjegojë rëndësinë e përgatitjes së raporteve për zbatimin, ecurinë dhe përmbylljen e projektit tekniko-ekonomik.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të krijojë kushtet teknike të nevojshme për montimin e pajisjeve të telekomunikacionit;
2. Të përzgjedhë burimet e nevojshme të ushqimit për instalimet e pajisjeve të telekomunikacionit;
3. Të zbatojë procedurat e montimit të pajisjeve të telekomunikacionit dhe aksesoreve përkatës sipas manualeve përkatëse;
4. Të zbatojë procedurat e instalimit të pajisjeve të telekomunikacionit në rrjet sipas manualeve përkatëse;
5. Të kryejë matjet dhe testimet e nevojshme gjatë kontrollit të instalimit të pajisjeve të telekomunikacionit;
6. Të dokumentojë të dhënat e matura nga matjet dhe testimet;
7. Të zbatojë metodat e përpunimit paraprak të të dhënave të marra nga instrumentet digjitale;
8. Të përgatisë raportet për zbatimin, ecurinë dhe përmbylljen e projektit tekniko-ekonomik.

Kriteret e vlerësimit

- Krijon kushteve e nevojshme teknike për montimin e pajisjeve të telekomunikacionit, sipas standardit teknik dhe projektit;
- Përzgjedh burimet e nevojshme të ushqimit për instalimet e pajisjeve të telekomunikacionit, sipas kërkesave teknike të projektit;
- Përzgjedh mjetet e punës për kryerjen e matjeve, testimeve dhe instalimeve të pajisjeve të telekomunikacionit, sipas kërkesave teknike të projektit;
- Kontrollon funksionalitetin e aparateve për matje dhe testime, sipas procedurës dhe manualeve përkatëse;
- Zbaton procedurat e instalimit të pajisjeve të telekomunikacionit dhe aksesoreve përkatës, sipas kërkesave teknike të projektit dhe manualeve përkatës;
- Mat dhe ruan vlerat e parametrave të pajisjeve të telekomunikacionit sipas procedurës përkatëse;
- Përpunon vlerat e matura të parametrave të pajisjeve të telekomunikacionit me anë të metodave të përpunimit paraprak;
- Teston pajisjet e instaluar të telekomunikacionit, sipas procedurës dhe manualeve përkatëse;
- Teston ndërlidhjen e pajisjeve të telekomunikacionit, sipas procedurës dhe manualeve

përkatëse;

- Krahason vlerat e parametrave të matura referuar kërkesave të projektit;
- Realizon përmirësimet e nevojshme në përputhje me kërkesat e projektit;
- Dokumenton në mënyrë periodike punën e kryer, sipas formateve përkatëse;
- Raporton në mënyrë periodike për zbatimin, ecurinë dhe përmbylljen e projektit tekniko-ekonomik sipas formateve përkatëse.

E7-05-IV-0167-24 Diagnostikimi i problemeve në komponentët teknike të telekomunikacionit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të interpretojë dokumentacionin teknik të nevojshëm për diagnostikimin e problemeve në komponentët teknike të telekomunikacionit;
2. Të përshkruajë procedurat e nevojshme të diagnostikimit dhe shërbimet e telekomunikacionit;
3. Të përshkruajë tipet e sinjaleve të transmetimit elektrik, optik, radio-vale, parametrat dhe karakteristikat e tyre;
4. Të shpjegojë llojet e pajisjeve dhe software-ve diagnostikuese dhe përdorimet e tyre;
5. Të shpjegojë llojet e defekteve në rrjet, shkaqet dhe pasojat e tyre;
6. Të analizojë rezultatet e vlerave të parametrave të matura në raport me referencat.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të shqyrtojë dokumentacionin e nevojshëm për problemet në rrjetin e telekomunikacionit;
2. Të kontrollojë pajisjen diagnostikuese për funksionalitet;
3. Të përdorë pajisje dhe software diagnostikuese për matje në mediumet e komunikimit;
4. Të zbatojë procedurat e nevojshme të diagnostikimit për identifikimin e defektit në rrjetin e telekomunikacionit.

Kriteret e vlerësimit

- Shqyrton siç duhet dokumentacionin e nevojshëm për problemet në rrjetin e telekomunikacionit;
- Përcakton radhën e punës për diagnostikim sipas llojit të problemit në rrjetin e telekomunikacionit;
- Kontrollon pajisjen diagnostikuese për funksionalitet sipas manualit;
- Mat parametrat e linjave kabllorë nëpërmjet pajisjes përkatëse;
- Mat sinjalin ajror (sinjale radio) nëpërmjet analizatorit përkatës;
- Përdor pajisjet dhe software-t diagnostikuese të problemeve në rrjetin e telekomunikacionit sipas manualeve përkatëse;
- Krahason parametrat e matura në komponentët e rrjetit me parametrat e referencës;
- Identifikon saktë defektin në rrjetin e telekomunikacionit duke u bazuar në matjet dhe testime përkatëse.

E7-05-IV-0168-24 Mirëmbajtje dhe riparime të infrastrukturës dhe pajisjeve të telekomunikacionit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë procedurën e riparimeve në rrjet sipas llojit të defektit;

2. Të theksojë rëndësinë e mirëmbajtjes së rrjetit dhe shërbimet e mirëmbajtjes në rrjet;
3. Të shpjegojë procesin e ngjitjes, lidhjes, bashkimit sipas llojit të kabullit dhe pajisjet e nevojshme ngjitëse;
4. Të interpretojë efektet anësore të bashkimeve të reja ose shtesë;
5. Të klasifikojë tipet e konektorëve sipas llojit të kabullit;
6. Të shpjegojë tipet e modulimit në linjat e transmetimeve;
7. Të shpjegojë rëndësinë e verifikimit të specifikimeve teknike të pajisjes zëvendësuese me atë të dëmtuar;
8. Të shpjegojë procedurat e zëvendësimit të pajisjeve të dëmtuara;
9. Të vlerësojë pasojat afatshkurtra dhe afatgjata të riparimeve në rrjet;
10. Të përshkruajë procedurat e testimeve të njëpasnjëshme sipas funksionalitetit dhe manualeve.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të përdorë pajisjet e nevojshme për riparimet e infrastrukturës dhe pajisjeve të telekomunikacionit;
2. Të kryejë mirëmbajtje periodike dhe të emergjencës në rrjetin e telekomunikacionit sipas procedurave të caktuara dhe grafikut;
3. Të zbatojë metodat e mirëmbajtjes për të parandaluar dështimet e mundshme të infrastrukturës dhe pajisjeve;
4. Të kryejë riparime në rrjetin e telekomunikacionit sipas procedurave përkatëse;
5. Të menaxhojë dokumentacionin dhe raportimet e nevojshme për riparimet dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së telekomunikacionit;
6. Të ofrojë mbështetje teknike dhe këshillim për përdoruesit dhe personelin teknik lidhur me riparime dhe mirëmbajtje.

Kriteret e vlerësimit:

- Përcakton metodën e riparimit sipas llojit të defektit;
- Përdor pajisjet e nevojshme për riparimet e infrastrukturës dhe pajisjeve të telekomunikacionit sipas manualeve përkatëse;
- Kryen procesin e ngjitjes, lidhjes, bashkimit sipas llojit të kabullit dhe pajisjet e nevojshme ngjitëse;
- Vlerëson efektet anësore të bashkimeve të reja ose shtesë sipas llojit të kabullit, në përputhje me kërkesat e standardit;
- Përzgjedh konektorët e përshtatshëm, sipas llojit të kabullit;
- Kryen riparime të thjeshta në rrjetin e telekomunikacionit sipas procedurave përkatëse;
- Përcakton tipin e modulimit në linjat e transmetimeve, sipas standardeve;
- Verifikon specifikimet teknike të pajisjes zëvendësuese me atë të dëmtuar;
- Zbaton procedurat e zëvendësimit të pajisjeve të dëmtuara, sipas manualit përkatës;
- Vlerëson dhe zbaton masat e nevojshme për të minimizuar ndërprerjet dhe dëmtimet në rrjet;
- Kryen testime të njëpasnjëshme sipas funksionalitetit dhe manualeve;
- Mbështet përdoruesit dhe personelin teknik lidhur me riparime dhe mirëmbajtje sipas rastit.

E7-05-IV-0169-24 Konfigurime bazë të pajisjeve të telekomunikacionit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë protokollet e komunikimit të të dhënave në rrjet;

2. Të përkufizojë protokollet e komutimit dhe të rrugëzimit;
3. Të shpjegojë bazat e modelit OSI³ dhe protokollit TCP/IP⁴;
4. Të shpjegojë llojet e pajisjeve të rrjetit të telekomunikacionit, funksionin dhe përdorimet e tyre;
5. Të shpjegojë konfigurimet bazë në pajisjet e rrjetit të telekomunikacionit, sipas procedurave përkatëse;
6. Të përshkruajë bazat e rrjetave të telekomunikacionit.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale:

1. Të kryejë konfigurime për pajisjet e telekomunikacionit në varësi të nevojave specifike;
2. Të kryejë identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të hasura gjatë konfigurimit në infrastrukturën e rrjetit;
3. Të zbatojë protokollet e nevojshme të sigurisë për të mbrojtur rrjetin dhe të dhënat;
4. Të ofrojë mbështetje teknike për përdoruesit dhe personelin teknik lidhur me konfigurimet e pajisjeve të telekomunikacionit.

Kriteret e vlerësimit:

- Përcakton protokollet e nevojshme të komunikimit të të dhënave në rrjet, sipas llojit të pajisjes;
- Identifikon protokollet e komutimit dhe të rrugëzimit sipas projektit teknik;
- Kryen konfigurimet bazë në pajisjet e rrjetit të telekomunikacionit, sipas procedurave përkatëse;
- Identifikon dhe zgjidh problemet e hasura gjatë konfigurimit në infrastrukturën e rrjetit sipas rastit;
- Zbaton protokollet e nevojshme të sigurisë për të mbrojtur rrjetin dhe të dhënat;
- Mbështet personelin teknik lidhur me konfigurimet e pajisjeve të telekomunikacionit;
- Siguron që të gjitha konfigurimet të jenë të dokumentuara ose të ruajtura në mënyrë digjitale.

E7-05-IV-0170-24 Teknologjia e informacionit në telekomunikacion

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të sistemeve/platformave online të menaxhimit të detyrave dhe sinjalizimeve të problemeve në rrjet;
2. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të teknologjive të informacionit për të realizuar konfigurimet e nevojshme në programet e rrjetit të telekomunikacionit;
3. Të shpjegojë domosdoshmërinë e përdorimit të teknologjive të informacionit për dokumentimin e punës;
4. Të shpjegojë rëndësinë e përditësimit në teknologjitë e informacionit dhe komunikimit;
5. Të shpjegojë mënyrën e përdorimit të mjeteve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për proceset e testimit, instalimit dhe riparimit;
6. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të sistemeve apo platformave online për kryerjen e porositve të materialeve/mjeteve të nevojshme të punës;
7. Të argumentojë rëndësinë e përdorimit të mjeteve të teknologjisë së informacionit, sistemeve

³Open Systems Interconnection

⁴Transmission Control Protocol/Internet Protocol

- dhe platformave të komunikimit brenda kompanisë dhe me klientin;
8. Të shpjegojë rëndësinë e përditësimit të software-ve në funksion të mirëmbajtjes së pajisjeve të komunikimit;
 9. Të shpjegojë përdorimin e aplikacioneve/programave të dedikuara për llogaritjen e parametrave jo të matshëm në mënyrë direkte;
 10. Të shpjegojë përdorimin e programeve të dedikuara për llogaritjen/leximin e parametrave të nevojshëm të instalimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të komponentëve të infrastrukturës së rrjetit të telekomunikacionit;
 11. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të shërbimeve cloud dhe të bazuara në cloud;
 12. Të përshkruajë njohuritë bazë të nevojshme për funksionimin e sistemeve operative dhe pajisjeve të rrjetit të komunikimit, si dhe përdorimet e tyre;
 13. Të përshkruajë masat e sigurisë kibernetike të pajisjeve në rrjetin e telekomunikacionit;
 14. Të argumentojë përdorimin e mjeteve të teknologjisë së informacionit në funksion të organizimit të punës dhe hartimit të raporteve.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të përdorë sistemet/platformat online të menaxhimit të detyrave dhe sinjalizimeve të problemeve në rrjet;
2. Të përdorë teknologjitë e informacionit për të realizuar komunikimin, konfigurimet e nevojshme, testimet, instalimet, mirëmbajtjen, riparimet, dokumentimin e punës etj.;
3. Të përdorë shërbimet cloud dhe të bazuara në cloud;
4. Të zbatojë procedurat dhe masat e sigurisë kibernetike të pajisjeve në rrjetin e telekomunikacionit.

Kriteret e vlerësimit

- Përdor sistemet/platformat online të menaxhimit të detyrave dhe sinjalizimeve të problemeve në rrjet;
- Përzgjedh dhe zbaton teknologjitë e informacionit për të realizuar konfigurimet e nevojshme në programet e rrjetit të telekomunikacionit;
- Përzgjedh dhe zbaton teknologjitë e informacionit për dokumentimin e punës;
- Përzgjedh dhe zbaton mjetet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për proceset e testimit, instalimit dhe riparimit;
- Përzgjedh dhe përdor sistemet apo platformat online për kryerjen e porosive të materialeve/mjeteve të nevojshme të punës;
- Përdor mjetet e teknologjisë së informacionit, sistemet dhe platformat e komunikimit brenda kompanisë dhe me klientin sipas rregullores së brendshme të organizatës;
- Përzgjedh dhe përdor software në funksion të mirëmbajtjes së pajisjeve të komunikimit sipas manualit të pajisjes;
- Përzgjedh dhe përdor aplikacionet/programet e dedikuara për llogaritjen e parametrave jo të matshëm në mënyrë direkte, sipas nevojave;
- Përzgjedh dhe përdor programet e dedikuara për llogaritjen/leximin e parametrave të nevojshëm të instalimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të komponentëve të infrastrukturës së rrjetit të telekomunikacionit;
- Përzgjedh dhe përdor shërbimet cloud dhe të bazuara në cloud, sipas kërkesave të organizatës;
- Zbaton procedurat dhe masat e sigurisë kibernetike të pajisjeve në rrjetin e

- telekomunikacionit;
- Harton raportet me mjetet e përzgjedhura të teknologjisë së informacionit sipas formateve dhe rregullores përkatëse.

E7-32-IV-0005-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë menaxhimin dhe rëndësinë në zhvillimin e biznesit, strukturat dhe rregulloret e brendshme të organizatës;
2. Të përshkruajë parimet bazë të legjislacionit të punës dhe të tatim taksave;
3. Të klasifikojë llojet e dokumentacioneve;
4. Të shpjegojë llojet e planeve periodike;
5. Të përshkruajë mënyrën e hartimit të një urdhri pune;
6. Të interpretojë format dhe mënyrat e ruajtjes së dokumentacioneve;
7. Të shpjegojë mënyrën e llogaritjeve të materialeve dhe kohës së punës;
8. Të përshkruajë mënyrën e përgatitjes së një oferte;
9. Të përshkruajë elementët e llogaritjes së kostos dhe çmimit të një shërbimi;
10. Të shpjegojë llojet e faturave dhe mënyrën e plotësimit të tyre;
11. Të diskutojë teknika të marketingut në fushën e telekomunikacionit.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë legjislacionin tatimor dhe kodin e punës në fuqi;
2. Të zbatojë detyrat administrative dhe tregtare;
3. Të zbatojë procedurat e sipërmarrjes në fushën e telekomunikacionit;
4. Të zbatojë teknikat e marketingut;
5. Të investojë kohë për zhvillimin profesional në fushën e telekomunikacionit.

Kritere vlerësimi:

- Zbaton legjislacionin tatimor, kodin e punës dhe legjislacionin e lidhur me aktivitetin që kryen;
- Harton një plan të thjeshtë biznesit, sipas specifikave përkatëse;
- Plotëson saktë planet periodike të punës, në përputhje me detyrat;
- Zbaton kushtet paraprake dhe procedurat për fillimin e një biznesi në fushën e telekomunikacionit, sipas legjislacionit në fuqi;
- Zbaton teknikat e duhura të marketingut;
- Merr periodikisht informacionin nga tregu për çmimet dhe cilësinë e mjeteve, materialeve, pajisjeve dhe komponentëve të sistemeve të telekomunikacionit;
- Përgatit oferta për produktet/shërbimet që do të ofrojë sipas llojit të shërbimit;
- Kryen llogaritje të sakta të kostos të një shërbimi të kryer në bazë të detyrës së dhënë;
- Llogarit çmimin përfundimtar për shërbimet e ofruara sipas rregullave referuar çmimeve të tregut;
- Bashkëpunon me institucione financiare, sipas legjislacionit dhe nevojës;
- Plotëson lloje të ndryshme të faturave, sipas produktit/shërbimit që do të ofrojë;
- Harton, ruan dhe arkivon raportet ditore, javore, mujore të punës, sipas rregullores së brendshme;

- Shkëmben udhëzime me bashkëpunëtorët për realizimin e detyrës duke përdorur terminologji profesionale dhe të qartë në komunikim;
- Vlerëson veten lidhur me mungesën e aftësive referuar proceseve të punës;
- Ndjek trajnimet për ngritje profesionale dhe teknika të reja në punë, sipas teknologjisë bashkëkohore;
- Transmeton njohuritë dhe teknikat e reja në punë tek bashkëpunëtorët sipas procesit të punës;
- Merr pjesë rregullisht në panairë dhe ekspozita në fushën e telekomunikacionit.

E7-31-IV-0006-24 Komunikimi dhe etika profesionale

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë komunikimin dhe teknikat e komunikimit;
2. Të shpjegojë standardet e kodit të etikës;
3. Të shpjegojë teknikat e punës në grup;
4. Të përshkruajë teknikat e zgjidhjes së problemeve dhe mendimit kritik;
5. Të listojë rregullat e komunikimit hierarkik dhe me palët e treta;
6. Të interpretojë terminologjinë profesionale;
7. Të përshkruajë rëndësinë e respektimit të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.;
8. Të argumentojë rëndësinë e komunikimit në gjuhë të huaj.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë teknikat e komunikimit;
2. Të zbatojë standardet e kodit të etikës në punë;
3. Të respektojë barazinë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj..

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal sipas kodit të etikës;
- Zbaton kodin e etikës sipas rregullores së brendshme;
- Punon në grup sipas parimeve të punës në grup;
- Përdor terminologjinë e duhur profesionale;
- Zbaton rregullat e komunikimit me klientët;
- Zbaton teknikat e motivimit për të arritur një komunikim të mirë me të tjerët;
- Zgjidh ankesat dhe mosmarrëveshjet me klientët, duke përdorur teknikat e duhura;
- Raporton tek mbikëqyrësi për detyrën e kryer, duke përdorur terminologji të qartë dhe profesionale;
- Respekton në mënyrë korrekte nivelet hierarkike dhe rëndësinë e komunikimit etik në organizatë;
- Zbaton rregullat për mbrojtjen e të dhënave në organizatë;
- Zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj. në komunikimin me të tjerët;
- Përdor terminologjinë e duhur profesionale në gjuhë të huaj.

E7-05-IV-0171-24 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë legjislacionin në fuqi për rregullat e sigurimit teknik;
2. Të përshkruajë rregullat e mbrojtjes së shëndetit gjatë procesit të punës;
3. Të përshkruajë standardin kombëtar për mbrojtjen nga rryma elektrike, mbrojtjen nga shoku elektrik, mbrojtjen nga efektet termike dhe mbirryma;
4. Të interpretojë manualat e pajisjeve;
5. Të interpretojë sinjalistikën në mjedisin e punës;
6. Të përshkruajë procedurat e evakuimit në raste emergjence;
7. Të shpjegojë përdorimin e mjeteve të mbrojtjes nga zjarri MNZSH;
8. Të shpjegojë llojet e mjeteve të ndihmës së parë dhe përdorimin e tyre;
9. Të përshkruajë procedurat e dhënies së ndihmës së parë;
10. Të shpjegojë pajisjet mbrojtëse individuale dhe kolektive dhe përdorimin e tyre;
11. Të përshkruajë karakteristikat e mjedisit të qëndrueshëm;
12. Të shpjegojë rregullat e ndarjes së mbetjeve dhe mbrojtjes së mjedisit;
13. Të theksojë rëndësinë e përdorimit në mënyrë racionale të energjisë, ujit dhe materialeve dhe burimeve të tjera.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë punës;
2. Të koordinojë masat për të minimizuar rrezikun e aksidenteve në vendin e punës.
3. Të japë ndihmën e parë në rast aksidenti;
4. Të zbatojë politika dhe strategji për mbrojtjen e mjedisit dhe përdorimin e burimeve të qëndrueshme.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton standardet dhe legjislacionin shqiptar lidhur me rregullat e sigurimit teknik në punë;
- Zbaton rregullat e sigurimit teknik për veten dhe ekipin në punimet në lartësi;
- Zbaton rregullat e sigurimit teknik gjatë punës në ambientet elektrike me tension dhe rrezik zjarri;
- Përdor pajisje mbrojtëse individuale dhe kolektive në punë sipas procedurës së punës;
- Përdor mjetet dhe pajisjet e punës sipas manualeve përkatëse;
- Përdor pajisjet e mbrojtjes nga zjarri, kontaktit me energjinë elektrike dhe shpëtimit sipas rregullores;
- Zbaton hapat e procedurës universale “LOTO”⁵ dhe sinjalistikës në mjedisin e punës;
- Identifikon dhe raporton tek personat përgjegjës për mosfunksionimin e mjeteve dhe pajisjeve të sigurisë teknike sipas rastit;
- Jep ndihmën e parë në rast aksidenti, goditje nga rryma elektrike, sipas rregullave përkatëse;
- Përdor mjetet e dhënies së ndihmës së parë me korrektësi;
- Zbaton procedurat e evakuimit për raste emergjence sipas protokolleve;
- Zbaton rregullat e mbrojtjes së mjedisit për ndarjen e mbetjeve sipas llojit;
- Zbaton rregulloret përkatëse për depozitimin e mbetjeve në përputhje me rregulloret e mjedisit;
- Zbaton rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen

⁵ LOTO (Lockout/Tagout) - Blloko/Etiketo. i referohet procedurave të përdorura për të siguruar që pajisja është e fikur dhe jashtwfunksionimit derisa të përfundojë puna e mirëmbajtjes ose riparimit

e mjedisit sipas legjislacionit;

- Merr masa për të minimizuar rrezikun e aksidenteve në vendin e punës, sipas rregullores së brendshme;
- Zbaton politika dhe strategji për mbrojtjen e mjedisit dhe përdorimin e burimeve të qëndrueshme;
- Zbaton protokollet e duhura në raste të gjendjes së jashtëzakonshme;
- Ndjek trajnime periodike për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik.

Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:

Nr.	Njësi të nxëni	Peshat në %	Kodet
	Planifikimi dhe organizimi i punës në sektorin e telekomunikacionit	10	E7-05-IV-0164-24
1	Punime për instalime të infrastrukturës mbështetëse të telekomunikacionit	10	E7-05-IV-0165-24
2	Instalime të pajisjeve të telekomunikacionit	10	E7-05-IV-0166-24
3	Diagnostikimi i problemeve në komponentët teknike të telekomunikacionit	12	E7-05-IV-0167-24
4	Mirëmbajtje dhe riparime të infrastrukturës dhe pajisjeve të telekomunikacionit	12	E7-05-IV-0168-24
5	Konfigurime bazë të pajisjeve të telekomunikacionit	12	E7-05-IV-0169-24
6	Teknologjia e informacionit në telekomunikacion	10	E7-05-IV-0170-24
7	Sipërmarrje dhe edukim karriere	8	E7-32-IV-0005-24
8	Komunikimi dhe etika profesionale	6	E7-31-IV-0006-24
9	Rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtja e mjedisit	10	E7-05-IV-0171-24
Totali		100	

Modalitetet e vlerësimit

Me vlerësim kuptojmë procesin gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së një rezultati të nxëni (RN), mbi bazën e kriterëve të caktuar.

Për vlerësimin mund të përdoren një shumëllojshëri metodash standarde dhe inovatore.

Individi i nënshtrohet vlerësimit të vazhduar, përmbledhës dhe vlerësimit përfundimtar për kualifikimet formale që ofrohen në ofrues të akredituar.

Individi vlerësohet për shkallën e përvetësimit të kompetencave të përgjithshme dhe profesionale, të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën përkatëse dhe vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së RN për realizimin e tërësisë së proceseve duke mbajtur evidenca për qëllime dokumentimi.

Realizimi i pranueshëm do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të specifikuar.

Dhënia e rezultatit të vlerësimit bëhet sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Kompetencat e përgjithshme vlerësohen të integruara si pjesë e vlerësimit të njësive të të nxënit.

Individit i lind e drejta të certifikohet për njësitë të nxëni specifike, si një kualifikimi i pjesshëm sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Informacion shtesë

Kualifikimet e plota ose të pjesshme profesionale mund të përftohen nëpërmjet këtyre formave:

- a) ndjekjes së arsimit profesional me bazë shkollën;
- b) ndjekjes së kurseve profesionale, ku përfshihen edhe praktikat profesionale në ndërmarrje apo forma të tjera të mësimnxënies praktike;
- c) regjistrimit si nxënës, duke u punësuar në një ndërmarrje (forma e dyfishtë);
- d) njohjes të të nxënit të mëparshëm informal dhe joformal;
- e) njohjes të të nxënit të përftuar jashtë vendit;
- f) formave të tjera të përcaktuara me ligj.

SHËNIM

Shpjegime të kodit të kualifikimit: **K-E7-IV-24**

K - Kualifikim

E - Shkronja që identifikon drejtimin e kualifikimit

7 - Numri që identifikon profilin e kualifikimit përkatës

IV - Shifra që identifikon nivelin sipas KSHK

24 - Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar kualifikimi

Shpjegime të kodit të njësisë së të nxënit: **E7-05-IV-0164-24**

E7 - Shkronja që identifikon drejtimin dhe profilin e kualifikimit

05 - Numri që identifikon orientimin e Njësisë së të Nxënit

IV - Shifra që tregon nivelin e Njësisë së të Nxënit në strukturën e KSHK

0164 - Numri rritës progresiv që tregon gjendjen e Njësive të të Nxënit në ditën e hartimit përkatës

24 - Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar Njësia e të Nxënit